

GRUPI I BANKËS BOTËRORE

EUROPA JUGLINDORE RAPORT I RREGULLT EKONOMIK

RESILIENT GROWTH AMID RISING RISKS

BOSNIA &
HERZEGOVINA

SERBIA

MONTEGREGO

KOSOVO

ALBANIA

FYR MACEDONIA

FALL 2016

Përfundimet kryesore të RRE nr.10:

- Të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor vijojnë të rriten, duke shfaqur përmirësime në rritjen e punësimit dhe uljen e varfërisë.
- Investimet vijojnë të kontribuojnë fuqishëm në rritjen ekonomike. Pas disa viteve të rritjes modeste, konsumi u rigjallërua me shpejtësi në të gjitha vendet për shkak të përmirësimit të rezultateve të tregut të punës dhe/ose pagave dhe transfertave më të larta publike.
- Vendet që ndjekin konsolidimin fiskal, patën përmirësim të llogarive fiskale, duke reduktuar deficitet, ulur rreziqet fiskale, dhe stabilizuar nivelet e borxhit. Por në vendet e tjera rritja e të ardhurave nuk arriti të kompensonte për rritjen e shpenzimeve, duke dëmtuar bilancet fiskale dhe nivelet e borxhit.
- Në kushtet e mjedisit kompleks global, ruajtja dhe konsolidimi i rritjes ekonomike kërkon përkushtim të vazhdueshëm për adresimin e pozitave të dobëta të jashtme, uljen e disbalancave fiskale dhe zbatimin me guxim të reformave strukturore.

Europa Juglindore

Raport i Rregeullt Ekonomik Nr.10

Rritje e Qëndrueshme Ekonomike Përballë Rreziqeve në Rritje

Vjeshtë 2016

Falënderime

Ky Raport i Rregullt Ekonomik (RRrE) mbulon zhvillimet ekonomike, perspektivat dhe politikat ekonomike në gjashtë shtete të Europës Juglindore (EJL6): Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, IRJ të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi.

Ky raport hartohet dy herë në vit nga ekonomistët e Bankës Botërore, të cilët punojnë në vendet e EJL6-ës. Ekipi i autorëve përfshin Barbara Cunha (udhëheqëse e ekipit dhe autore kryesore), Ekaterina Vostroknutova (udhëheqëse e ekipit), Agim Demukaj, Sandra Hlivnjak, Johanna Jaeger, Alena Kantarovich, Sanja Madžarević-Šujster, Olasupo Olusi, Lazar Šestović, Hilda Shijaku, Bojan Shimbov, Ashley Taylor, dhe Michelle Tejada. Anne Grant ka ndihmuar në redaktimin e këtij raporti, dhe Budy Ęirasmo, Artem Kolesnikov, dhe Robert Ęaiharo në dizenjimin e tij. Valentina Martinovic, Nejme Kotere, Samra Bajramovic, Ivana Bojic, Enkelejda Karaj, Hermina Vukovic Tasic, Jasminka Sopova, Boba Vukoslavovic, dhe Dragana Varezić kanë ndihmuar ekipin.

Shpërndarja e raportit, marrëdhëniet me jashtë dhe ato me median janë menaxhuar nga ekipi për Marrëdhëniet me Jashtë i përbërë nga Lundrim Aliu, Anita Božinovska, Paul A. Clare, Ana Gjokutaj, Jasmina Hadžić, Carl Hanlon, Elena Karaban, Artem Kolesnikov, Vesna Kostić, John Mackedon, Mirjana Popović, dhe Sanja Tanić.

Ekipi shpreh mirënjohjen e vet ndaj Ellen Goldstein (Drejtoreshë për Shtetin, Europa Juglindore), John Panzer (Drejtoreshë, Praktika Globale në Makroekonomi dhe Menaxhim Fiskal), Gallina A. Vincelette (Menaxher i Praktikave, Praktika Globale në Makroekonomi dhe Menaxhim Fiskal), Ivailo Izvorski (Menaxher i Praktikave, Praktika Globale në Makroekonomi dhe Menaxhim Fiskal) dhe për ekipin Menaxhues të Vendeve të Europës Juglindore për udhëzimet e tyre në përgatitjen e këtij raporti. Ekipi shpreh gjithashtu mirënjohje për komentet mbi draftet paraprake të këtij raporti, të dërguara nga Bankat Qendrore dhe Ministrinë e Financave të vendeve të EJL6-ës.

Ky raport si dhe raportet e mëparshme të RRrE-së për Evropën Juglindore mund të gjenden në: www.worldbank.org/eca/seerer

Deklaratë Standarde për Kufizim të Përgjegjësisë:

Ky volum është produkt i stafit të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore. Gjetjet, interpretimet, dhe përfundimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore, ose të qeverive që ata përfaqësojnë. Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë raport. Kufijtë, ngjyrat, përcaktimet ose informacionet e tjera të përfshira në çdo njëërën ndër hartat në këtë dokument nuk nënkuptojnë asnjë interpretim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori, ose miratimin apo pranimin e këtyre kufijve.

Deklaratë mbi të Drejtat e Autorit:

Materiali në këtë botim është i mbrojtur nga drejta e autorit. Kopjimi ose transmetimi pa leje i ndonjë pjese ose punimit në tërësi mund të përbëjë një shkelje të ligjit në fuqi. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore inkurajon shpërndarjen e punës së saj dhe normalisht jep leje menjëherë për riprodhimin e pjesëve të raportit. Për sigurimin e lejes për të fotokopjuar ose rishtypur ndonjë pjesë të këtij dokumenti, ju lutem dërgoni një kërkesë me informacion të plotë në Copyright Clearance Center, Inc., 222 Rosewood Drive, Danvers, MA 01923, USA, telefon 978-750-8400, fax 978-750-4470, <http://www.copyright.com/>. Të gjitha pyetjet e tjera lidhur me të drejtat dhe licencat, duke përfshirë të drejtat e riprodhimit, duhet të drejtohen në adresën, Office of the Publisher, The World Bank, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA, fax 202-522-2422, e-mail pubrights@worldbank.org.

Përmbajtja

Përmbledhje	VIII
Rritje e Qëndrueshme Ekonomike Përballë Rreziqeve në Rritje	1
1. Zgjerim Modest Ekonomik por me Rreziqe më të Larta	3
2. Më Shumë Vende Pune, por Papunësia Mbetet Kokëfortë	7
3. Pozicionet e Jashtme Vijnë të Mbeten të Brishta	10
4. Konsolidimi Fiskal po Jep Fryte	13
5. Kreditimi po Zgjerohet, por Vijnë të Pengohet nga Cilësia e Aseteve	16
6. E Ardhmja	19
EJL6: Treguesit Kryesorë Ekonomikë	21

Lista e Figurave

FIGURA 1.1 RITJA EKONOMIKE E SEE6-ËS PO FORCOHET	3
FIGURA 1.2. INVESTIMET DHE KONSUMI PO MBËSHITESIN RITJEN EKONOMIKE	4
FIGURA 2.1. PUNËSIMI E KA TË VËSHITRË TË ARRIJË NIVELIN E PARA-KRIJZËS	7
FIGURA 2.2 NORMA E PAPUNËSISË MBETET E LARTË	7
FIGURA 3.1. DEFICITET E LLOGARIVE KORRENTE PATËN RITJE TË VOGËL NË 2016, PËRVECSE NË SERBI	10
FIGURA 3.2. DEFICITET TREGTARE PËRKEQËSUAN BILANCET E LLOGARIVE KORRENTE.....	10
FIGURA 3.3. IHD-TË DHE INVETSIMET E PORTOFOLIT U REDUKTUAN	11
FIGURA 3.4. ...NË SHUMICËN E VENDEVE TË EJL6-ËS	11
FIGURA 4.1. KONSOLIDIMI FISCAL REDUKTOI DEFICITET NË SHQIPËRI DHE SERBI	13
FIGURA 4.2. ...POR PRESIONI I SHPENZIMEVE NUK SHOQËROHET ME RITJE TË PERFORMANCËS NË TË ARDHURA NË SHUMICËN E VENDEVE	13
FIGURA 4.3. KONSOLIDIMI FISCAL NDIHMOI NË STABILIZIMIN E BORXHIT PUBLIK NË SHQIPËRI DHE SERBI.....	14
FIGURA 5.1. FORCIMI I AKTIVITETIT EKONOMIK KA STIMULUAR KËRKESËN E SEKTORIT PRIVAT PËR KREDI	16
FIGURA 5.2. RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT MBETET NË NIVELIN E DUHUR.....	17
FIGURA 5.3. KREDITË ME PROBLEME KRYESISHT U REDUKTUAN	17

Lista e Tabelave

TABELA A.1.1: KONSOLIDIMI I RIMËKËMBJES DERI NË 2018	VIII
TABELA 1.1. PERPSEKTIVË POZITIVE E RITJES EKONOMIKE	4
TABELA 3.1. SHTRËNGIM I POZICIONIT TË JASHTËM TË EJL6-ËS.....	11
TABELA 4.1. EJL6: ZHVILLIMET DHE PERSPEKTIVA FISKALE.....	15

Përmbledhje

Gjashtë vendet e Europës Juglindore (EJL6) - Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina (BeH), Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi, dhe Serbia - duhet të veprojnë në një mjedis kompleks global. Pasiguria politike, institucionale, dhe e politikave ekonomike në vendet e zhvilluara, çmimet ende të ulëta për lëndët e para, dhe normat veçanërisht të ulëta të interesit ulin pritshmëritë e rritjes së ekonomisë globale. Ritmet e rritjes ekonomike janë ngadalësuar kudo, dhe rritja ekonomike e Bashkimit Europian (BE), një destinacion i rëndësishëm për eksportet e EJL6-ës, këtë vit vlerësohet të jetë 1.9 për qind, që është më e ulët se niveli 2 për qind në vitin e mëparshëm. Pasiguria në Europë është rritur për shkak të vendimit të referendumit në Mbretërinë e Bashkuar për të dalë nga BE-ja, krizës së vazhdueshme në Greqi, presionit mbi bankat Italiane, tensioneve politike në Turqi, si dhe vazhdimin të krizës së refugjatëve. Brexit ka ripërtërirë debatin për të ardhmen e BE-së dhe ndikimin e mundshëm në vendet që janë në rrugën drejt anëtarësimit në BE. Megjithatë, vendet e EJL6-ës vijojnë të ndjekin në mënyrë të vendosur aspiratat e tyre për integrimin në BE, dhe disa prej këtyre vendeve kanë çelur kapituj të rinj këtë vit.

Tabela A.1.1: Konsolidimi i rimëkëmbjes deri në 2018

Rritja e PBB-së reale (në përqindje)	2015	2016 ^f	2017 ^f	2018 ^f
Shqipëria	2.8	3.2	3.5	3.5
Bosnja dhe Hercegovina	3.0	2.8	3.2	3.7
Kosova	3.9	3.6	3.9	3.7
IRJ e Maqedonisë	3.7	2.0	3.3	3.7
Mali i Zi	3.2	3.2	3.6	3.0
Serbia	0.7	2.5	2.8	3.5
EJL6	2.2	2.7	3.2	3.6

Burimi: Të dhëna nga bankat qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave, parashikime të stafit të Bankës Botërore

Pavarësisht faktorëve të jashtëm, ritmet e rritjes ekonomike në rajonin e EJL6-ës po konsolidohen. Ne parashikojmë që rritja ekonomike në vitin 2016 të forcohet në 2.7 përqind krahasuar me 2.2 për qind në vitin 2015, duke u stimuluar nga investimet e fuqishme dhe rigjallërimi i konsumit të familjeve. Zgjerimi ekonomik i rajonit reflekton rimëkëmbjen e rritjes ekonomike kryesisht në Serbi, por edhe në Shqipëri (Tabela A). Investimet vijojnë të jenë faktori kryesor nxitës i rritjes ekonomike, sidomos në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi. Pas disa viteve me rritje të vogël, edhe konsumi filloi të rritet me shpejtësi, i stimuluar kryesisht nga përmirësimet në tregun e punës (Shqipëri, Kosovë, dhe Serbi) dhe rritjes së pagave dhe transfertave publike (IRJ e Maqedonisë dhe Mali i Zi).

Rritja e qëndrueshme ekonomike dhe reformat e tregut të punës vijojnë të mbështesin krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin privat. Zvogëlimi i ngurtësive të tregut të punës në kombinim me rritjen e fortë ekonomike, ka rezultuar në rritjen e punësimit me 4.7 për qind në Serbi, në gjysmën e parë të vitit 2016. Përpjekjet për formalizimin e tregut të punës kontribuan në rritjen e punësimit me 6.7 përqind në Shqipëri. Megjithatë, pavarësisht përmirësimeve të fundit, niveli i punësimit është ende nën nivelet e para-krizës në të gjitha vendet e EJL6-ës, me përjashtim të IRJ të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Papunësia vijoi të reduktohet në shumicën e vendeve me përjashtim të Malit të Zi, ku ajo u rrit pjesërisht për shkak të zgjedhjeve të politikave publike të kohëve të fundit. Megjithatë, niveli mesatar rajonal i papunësisë mbetet ende i lartë në rreth 25 për qind.

Rreziqet për perspektivën afatshkurtër të EJL6-ës janë në rritje, ku vecanërisht të pambrojtura janë pozicionet e jashtme të vendeve të EJL-6. Deficiti i llogarisë korrente (CAD) të rajonit në vitin 2016 pritet të jetë 6.4 përqind e PBB-së, që është më i lartë se ai i vitit 2015, pasi ngushtimi i deficitit të Serbisë do të balancohet nga rritja e deficiteve të vendeve fqinje të saj. Në Shqipëri, Mal të Zi dhe Kosovë, kjo tendencë e rritjes së CAD-ve shpjegohet nga rritja e deficiteve tregtare, rënia e remitancave, dhe pagesat e dividendëve për investitorët jorezidentë. Flukset më të ulëta të të ardhurave dhe remitancave janë faktorët ndikues të rritjes së CAD-ve të Bosnje dhe Herzegovinës (BeH) dhe IRJ të Maqedonisë. Pas rritjes së shpejtë në

vitin 2015, hyrjet neto të investimeve të huaja direkte (IHD), si përqindje e PBB-së, pësuan rënie në vitin 2016, por ato do të vijojnë të financojnë një pjesë të madhe të CAD-ve. Investimet e portofolit janë në rënie për disa periudha rradhazi, duke reflektuar zhvillimet negative në tregjet ndërkombëtare.

Vendet që vijuan me vendosmëri përpjekjet e konsolidimit fiskal arritën të stabilizojnë borxhet e tyre publike dhe publikisht të garantuara (PPG) për herë të parë që prej fillimit të krizës globale. Konsolidimi fiskal ka filluar të japë fryte, duke ndihmuar në reduktimin e deficitit fiskal mesatar të rajonit nga 3.6 përqind e PBB-së në vitin 2015 në 3.4 përqind në vitin 2016. Këto rezultate ishin më të theksuara në Shqipëri, BeH, dhe Serbi, të cilat vijojnë përpjekjet e tyre për konsolidimin fiskal dhe pritet që këtë vit të regjistrojnë deficite fiskale të ulëta ose në rënie dhe zvogëlim të borxhit publik dhe borxhit publik të garantuar (PPG) për herë të parë që prej vitit 2009. Në të kundërt, pozicionet fiskale ka të ngjarë të përkeqësohen në Kosovë, IRJ të Maqedonisë, dhe Mal të Zi, duke çuar në nivele më të larta të borxheve PPG.

Kreditimi për sektorin privat po rigjallërohet me ritme të ngadalta në shumicën e vendeve të EJL6-ës. Rritja e kreditimit është rimëkëmbur në Serbi, për shkak të përsheptimit të aktivitetit ekonomik. Në mënyrë të ngjashme, dhënia e kredive të reja është zgjeruar në Shqipëri, veçanërisht për segmentin e konsumit, dhe Kosovë, e shtyrë nga normat më të ulëta të interesit të kredive. Rritja e kreditimit vijoi të ishte pozitive në IRJ të Maqedonisë dhe Kosovë, megjithëse rënia e besimit preku kreditimin e korporatave në pjesën e parë të 2016. Rritja e kreditimit ishte më e dobët në

Mal të Zi për shkak të kërkesës së ulët për kredi nga segmenti i korporatave; ndërsa kushtet e ofrimit të kredive ndikuan në nivelin e ulët të rritjes së tyre në BeH. Megjithëse bankat në rajon janë fitimprurëse, me nivel të mirë likuiditeti dhe kapitalizimi, niveli i kredive me probleme (NPL) është akoma më i lartë se para krizës.

Perspektivat afatshkurtra të rritjes ekonomike për vendet e EJL6-ës janë pozitive, por rreziqet nxjerrin në pah rëndësinë e reformave strukturore për ribalancim të suksesshëm midis burimeve të brendshme dhe të jashtme të rritjes ekonomike. Ritmet e rritjes ekonomike në rajon parashikohet të përshejtohen nga 2.7 për qind në vitin 2016 në 3.6 për qind në vitin 2018 për shkak të rritjes së kërkesës së brendshme - investimeve me mbështetjen e konsumit - si dhe të rigjallërimit të eksporteve. Megjithatë, perspektivat e rritjes ekonomike në BE, si dhe paqartësitë e tjera në rajon do të vazhdojnë të ulin parashikimet e rritjes


ekonomike të EJL6-ës. Në kushtet kur shumica e vendeve të rajonit ose sapo kanë dalë ose janë duke hyrë në ciklin e zgjedhjeve, pasiguria politike po shton rreziqet, edhe pse fillimi i një cikli të ri politik ofron një mundësi për të çuar përpara reformat strukturore. Problemet që janë duke kufizuar rritjen ekonomike potenciale të EJL6-ës janë papunësia vazhdimisht e lartë, mjedisi i varfër i biznesit dhe qeverisjes, ofrimi i dobët shërbimeve publike, dhe integrimi i cekët global.

Rritje e Qëndrueshme Ekonomike Përballë Rreziqeve në Rritje

1. Zgjerim Modest Ekonomik por me Rreziqe më të Larta

Rritja ekonomike e EJL6-ës ka të ngjarë të arrijë në 2.7 përqind këtë vit, e udhëhequr nga rimëkëmbja ekonomike në Serbi, ku PBB-ja pritet të rritet me 2.5 përqind (Figura 1.1). Pas rritjes negative ose minimale në vitin 2014 dhe 2015, PBB-ja reale e Serbisë, ekonomisë më të madhe të EJL6-ës, u rikthye në nivelin e saj të para krizës –duke qenë vendi i fundit i rajonit që e arrin këtë. Vendet e tjera të EJL6-ës pritet të kenë të njëjtën performancë si edhe vitin e mëparshëm, me një përmirësim të vogël në rritjen ekonomike të Shqipërisë, rritje e qëndrueshme ekonomike për Malin e Zi, si dhe ngadalësimi i butë për Bosnje dhe Hercegovinën (në 2.8 përqind) dhe Kosovën (në 3.6 përqind). Ritmi i rritjes ekonomike në IRJ të Maqedonisë pritet të ngadalësohet në mënyrë të menjëhershme nga 3.7 përqind në vitin 2015 në 2 përqind në vitin 2016, për shkak të pasigurisë së tejzgjatur politike, e cila zvogëlon aktivitetin ekonomik dhe investimet private në veçanti.

Figura 1.1 Rritja ekonomike e SEE6-ës po forcohet



Burimi: Të dhëna nga bankat qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave, parashikime të stafit të Bankës Botërore


Investimet vijojnë të japin kontribut të fuqishëm në rritjen ekonomike. Në vitin 2016, investimet pritet të jenë burimi kryesor i rritjes ekonomike për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë dhe një burim i fuqishëm për Kosovën dhe BeH (Figura 1.2). Investimet private në projektet e mëdha të infrastrukturës kanë nxitur rritjen ekonomike në Shqipëri (kryesisht në sektorin e energjisë) dhe Bosnjë dhe Hercegovinë (energji dhe turizëm). Për Serbinë, rol parësor kanë luajtur investimet private, të nxitura kryesisht nga investimet e huaja direkte (IHD) në industrinë përpunuese dhe ndërtim. Kosova pritet të përfitojë si nga investimet publike (kryesisht në rrugë) dhe nga investimet private vendase. Rritja ekonomike e Malit të Zi është mbështetur nga një projekt i madh autostrade me financim publik. IRJ e Maqedonisë është vendi i vetëm i EJL6-ës ku investimet pritet të kufizojnë rritjen ekonomike; investimet publike nuk kanë qenë të mjaftueshme për të kompensuar rënien e madhe të investimeve private. Pasiguria e tejzgjatur politike ka dobësuar investimet, të cilat- për herë të parë në gjashtë vitet e fundit- kanë pasur ndikim negativ në rritjen ekonomike të IRJ të Maqedonisë.

Konsumi është, përsëri, një burim kryesor i rritjes ekonomike. Konsumi i brendshëm, një motor i fuqishëm i rritjes ekonomike menjëherë pas krizës, ka pasur një rol relativisht të kufizuar në vitin 2015, por që më pas ka ardhur duke u zgjeruar. Ai udhëhiqet nga konsumi


Figura 1.2. Investimet dhe konsumi po mbështesin rritjen ekonomike

Struktura e eëitjes së PBB reale, përqind

2012-15



2016



Burimi: Të dhëna nga bankat qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave, parashikime të stafit të Bankës Botërore.

privat, i cili kryesisht është stimuluar nga zhvillimet pozitive ekonomike dhe të tregut punës (Shqipëria, Serbia, BeH dhe Kosova) ose nga pagat dhe transfertat bujare publike (IRJ e Maqedonisë, Kosova dhe Mali i Zi). Në kushtet kur disa vende po vijnë me progresin në konsolidimin fiskal, rritja e konsumit të qeverisë është ngadalësuar.

Me rritjen e importeve, kontributi i eksporteve neto bëhet negativ. Eksportet neto kanë kontribut negativ në rritjen ekonomike të këtij viti në të gjitha vendet me përjashtim të Serbisë, ku eksportet e industrisë përpunuese kanë ecuri pozitive, dhe Malit të Zi, për shkak të turizmit. Ndryshe nga viti 2015, eksportet e shërbimeve nuk kanë qenë në gjendje për të kompensuar efektet e zgjatura të çmimeve të ulëta ndërkombëtare të lëndëve të para në Shqipëri dhe Kosovë. Importet janë në rritje në të gjitha vendet, duke u stimuluar kryesisht nga importet për qëllime të investimeve, dhe në një masë më të vogël nga ato për qëllime konsumi.

Tabela 1.1. Perspektivë pozitive e rritjes ekonomike

Rritja e PBB-së reale (në përqindje)	2015	2016 ^f	2017 ^f	2018 ^f
Shqipëria	2.8	3.2	3.5	3.5
Bosnja dhe Hercegovina	3.0	2.8	3.2	3.7
Kosova	3.9	3.6	3.9	3.7
IRJ e Maqedonisë	3.7	2.0	3.3	3.7
Mali i Zi	3.2	3.2	3.6	3.0
Serbia	0.7	2.5	2.8	3.5
EJL6	2.2	2.7	3.2	3.6

Burimi: Të dhëna nga bankat qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave, parashikime të stafit të Bankës Botërore

Perspektiva afat-shkurtër e rritjes ekonomike të EJL6-ës është pozitive (Tabela 1.1). Rritja ekonomike në rajon parashikohet të forcohet nga 2.2 për qind në vitin 2015 në 3.6 për qind në vitin 2018 për shkak të intensifikimit të kërkesës së brendshme, e nxitur nga investimet me mbështetjen e konsumit, dhe rimëkëmbjes së eksporteve. Në Serbi, BeH, dhe IRJ të Maqedonisë, ritmet e rritjes ekonomike pritet të përshpejtohen në periudhë afatmesme, për shkak të investimeve të diversifikuara në aktivitete prodhuese dhe

konsumit privat. Në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi-vendet ku projektet e mëdha publike janë pjesë e zgjerimit ekonomik-rritja ekonomike parashikohet të ngadalësohet për shkak të efektit të stabilizimit të aktiviteteve të projekteve. Megjithatë, konsumi pritet të qëndrojë i fortë, i mbështetur nga përmirësimet e vazhdueshme në rezultatet e tregut të punës. Eksportet do të përfitojnë nga perspektiva e qëndrueshme e BE-së.

Rreziqet për perspektivën pozitive janë të lidhura me rritjen e presionit të jashtëm. Zgjerimi i ngadaltë ekonomik i BE-së, pasiguria në lidhje me efektet e Brexit, dobësia e vazhdueshme e Greqisë, tensionet politike në Turqi, dhe kriza e refugjatëve do të vazhdojnë të krijojnë probleme për perspektivat e rritjes ekonomike të EJL6-ës. Ndërkohë që ndikimi i drejtpërdrejtë i Brexit në EJL6 pritet të jetë i vogël, rritja më e ngadaltë ekonomike e BE-së sesa pritshmëritë mund të ketë pasoja të rëndësishme indirekte. Ndikimi mund të vijë nëpërmjet tregtisë, rritjes ekonomike, dhe kanaleve të sektorit financiar; BE-ja është partneri më i madh tregtar i EJL6-ës dhe shumica e IHD-ve të saj është me origjinë nga BE-ja. Lulahshmëria e rritur mund të shkaktojë zhvendosjen e investitorëve drejt cilësisë pasi rritet sjellja kundërshtuese ndaj riskut, duke ndikuar financimin e jashtëm nëpërmjet normave të interesit, kurseve të këmbimit dhe flukseve të kapitalit. Kjo do të bëjë më të vështirë plotësimin e nevojave, relativisht të mëdha, të rajonit për financim. Rritja e pasigurisë në lidhje me stabilitetin bankar në Itali apo vende të tjera të BE-së të goditura nga Brexit mund të ndikojë në bankat mëmë të ndërmjetësve rajonale, duke çuar në reduktim të mëtejshëm të

levës financiare dhe shtrëngim më të madh të kreditimit. Megjithatë, financimi i brendshëm dhe orientimi drejt tregjeve kombëtare i shumicës së sistemeve financiare/bankare është një faktor lehtësues për të gjitha vendet e rajonit. Së fundmi, tensionet politike dhe shqetësimet për sigurinë në Turqi mund të sjellin një ngadalësim të mundshëm të rritjes ekonomike të Turqisë. Kjo mund të ndikojë disi në vendet e EJL6-ës përmes lidhjeve të tregtisë dhe investimeve, por mund të rezultojë edhe në një rritje të turizmit në këto vende.

Në kushtet kur shumica e vendeve sapo kanë dalë nga ose do të hyjnë në proces zgjedhesh, pasiguria politike është rritur. Në të kaluarën, zgjedhjet në vendet e EJL6-ës janë shoqëruar shpesh me shpenzime shtesë ose mbledhje më të ulët të të ardhurave. Këtë herë, të paktën Shqipëria, BeH, dhe Serbia duket se kanë devijuar nga ky model. Megjithatë, me afrimin e zgjedhjeve presioni mund të rritet, dhe mund të ngadalësojë konsolidimin. Në IRJ të Maqedonisë, efektet e trazirave të zgjatura politike dhe pasiguria rreth zgjedhjeve kanë filluar të dobësojnë ekonominë. Edhe pse IHD-të kanë qenë disi fleksibël në këtë vend, investimet e brendshme ka rënë ndjeshëm. Në anën fiskale, pagat, pensionet dhe transfertat janë rritur ndjeshëm gjatë këtij viti në IRJ të Maqedonisë dhe Mal të Zi, ndërsa planifikimi dhe menaxhimi i dobët investimeve mund të çojnë në akumulimin e borxheve të reja në Shqipëri. Së fundi, paqëndrueshmëria e zgjatur politike dhe mungesa e marrëveshjes për tema të ndjeshme të tilla si demarkacioni i kufirit me Malin e Zi, kanë filluar të dekurajojnë investimet e huaja direkte në Kosovë. Fillimi i punës nga qeveritë e reja krijon një

hov pozitiv për reformat strukturore që lidhen me rregullat e tregut të punës, klimën e biznesit, efikasitetin e investimeve dhe shërbimeve publike, si dhe integrimin ekonomik dhe ky hov mund të ndihmojë në përshpejtimin e ritmeve të rritjes ekonomike.


2. Më Shumë Vende Pune, por Papunësia Mbetet Kokëfortë

Rritja e fortë ekonomike dhe reformat e ndërmarra në tregun e punës kanë vijuar të mbështesin krijimin e vendeve të punës edhe në vitin 2016, sidomos në sektorin privat. Punësimi mbetet ende poshtë niveleve të para-krizës në të gjitha vendet e rajonit me përjashtim të IRJ të Maqedonisë dhe Malit të Zi (Figurat 2.1 dhe 2.2). Reformat e fundit në tregun e punës në Serbi (2014) dhe BeH (2015), kanë filluar të japin frytet e veta. Reduktimi i ngurtësive në tregun e punës në Serbi, së bashku me fuqizimin e aktivitetit ekonomik, kanë çuar në rritje të punësimit prej 4.7 përqind në terma vjetorë, ku gjysma i përket sektorit formal. Përpjekjet për formalizimin e tregut të punës në Shqipëri, kanë kontribuar në rimëkëmbjen ekonomike të vendit, duke çuar në rritje të punësimit prej 6.7 përqind, kryesisht në sektorin e

shërbimeve dhe industrinë përpunuese Pavarësisht krijimit të vazhdueshëm të vendeve të reja të punës në turizëm dhe ndërtim, rritja e punësimit në Malin e Zi është zbehur pasi shumë gra lanë punën për të përfituar kompensimin e ri jetësor për nënat me fëmijë.


Zhvillimet pozitive në tregun e punës po çojnë në ulje të papunësinë në të gjitha vendet e EJL6-ës, me përjashtim të Malit të Zi. Papunësia ra me 0.7 pp në Shqipëri dhe 1.1 pp në Serbi në gjysmën e parë të vitit 2016, pavarësisht zgjerimit të pjesëmarrjes në forcën e punës. Nga ana tjetër, rënia e pjesëmarrjes në forcën e punës çoi në ulje të mëtejshme të papunësisë në BeH (me 2.3 pp) dhe IRJ të Maqedonisë (me 1.8 pp). Ndërkaq, Mali i Zi mbetet vendi i vetëm ku fenomeni i papunësisë është përkeqësuar.

Figura 2.1. Punësimi e ka të vështirë të arrijë nivelin e para-kriizës



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave.

Figura 2.2 Norma e papunësisë mbetet e lartë



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave.

Shënim: Papunësia afatgjatë paraqitet si përqindje e forcës së punës, në vënd të përqindjes së të papunëve. Janë përdorur ndryshimet Qershor 2010 deri në Qershor 2016

Pavarësisht zhvillimeve të fundit pozitive, papunësia në rajon për vitin 2016 mbetet e lartë, pothuajse mesatarisht 25 përqind e forcës së punës, duke filluar nga 17 përqind në Shqipëri deri në rreth 33 përqind në Kosovë; më shumë se 66 përqind e të

papunëve kanë qenë të tillë për periudha afatgjata (Figura 1.2). Shkalla e papunësisë të të rinjtë është pothuaj dy herë më e lartë se ai ajo popullsisë në moshë pune, e cila sjell pasoja për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen (Hapësira Informuese 1).

Hapësira Informuese 1. Papunësia te të rinjtë në EJL6

Aktualisht, rreth 25 përqind e të rinjve në gjashtë vendet e Europës Juglindore (EJL6) nuk është aktive – në punësim, arsim, ose trajnim. Nivelet e larta të vazhdueshme të papunësisë tek të rinjtë variojnë nga 38.8 përqind në Mal të Zi në 54.3 përqind në Bosnjë dhe Hercegovinë. Këto probleme reflektojnë pjesërisht vështirësitë që kanë hasur vendet e EJL6-ës gjatë rimëkëmbjes nga kriza financiare e vitit 2008, e cila çoi në rritje të skajshme të nivelit aktualisht të lartë të papunësisë tek të rinjtë.

Rritja ekonomike prek më shumë mundësitë për punësimin e të rinjve sesa të të rriturve. Megjithatë krizat ndikojnë më negativisht tek të rinjtë, në periudha të zgjerimit ekonomik krijimi i vendeve të reja të punës për të rinjtë kërkon një rritje më të vogël ekonomike sesa për të rriturit.

Rezultatet e dobëta në tregun e punës nxjerrin gjithashtu në pah probleme më të thella strukturore në vendet e EJL6-ës, ku jo vetëm papunësia mbetet e lartë, por edhe pjesëmarrja në forcën e punës është e ulët, veçanërisht për gratë e reja dhe minoritetet. Mungesa e fleksibilitetit në rregullimin e tregut të punës kufizon mundësitë për ata që hyjnë në këtë treg, ndërkohë që edhe tatimi për punë me kohë të pjesshme dhe paga të ulëta – ku punojnë kryesisht të rinj - është relativisht i lartë duke dekurajuar në këtë mënyrë punësimin në këtë lloj pune.

Personat që hyjnë në tregjet e punës në EJL6 nuk zotërojnë aftësitë e kërkuara nga punëdhënësit. Mungesa e aksesit në inputet prodhuese dhe lidhjet profesionale e përkeqëson më tej perspektivën e tyre për sipërmarrje dhe punësim. Së fundi, norma të caktuara kulturore mund të çojnë në kufizim të mundësive për punësimin e të rinjve, veçanërisht për gratë dhe pakicat etnike; për këtë arsye nevojiten politika të rëndësishme kundërvepruese me qëllim rritjen e aksesit ndaj shërbimeve cilësore dhe të përballueshme të kujdesit për fëmijët si dhe përpjekje afatgjata për ndryshimin e normave dhe krijimin e shanseve të barabarta.

Adresimi i sfidave me të cilat përballen të rinjtë që janë të papunë për shkak të papunësisë ciklike dhe strukturore kërkon politika të posaçme. Me rëndësi jetike mbetet angazhimi i të rinjve në tregun e punës gjatë periudhave të recesionit dhe investimi në kapitalin e tyre njerëzor gjatë rimëkëmbjes së tregut të punës. Axhenda e politikave për papunësinë strukturore është më e thellë; ajo kërkon adresimin e barrierave ndaj punësimin të të rinjve të cilat janë të rrënjosura në rregulloret përjashtuese të punës dhe tatimin mbi punën; kualifikimin e tyre sipas nevojave të tregut të punës; si dhe përmirësimin e aksesit në inputet prodhuese, të tilla si toka, financat, dhe në lidhjet profesionale.

Burimi: Raporti i Rregullt Ekonomik për Europën Juglindore, Temë e Veçantë: Dhjetë Mesazhe për Punësimin e të Rinjve në Europën Juglindore, Banka Botërore (raporti i ardhshëm).

Inflacioni i ulët, së bashku me performancën e përmirësuar të tregut të punës, ka ndihmuar në rritjen e fuqisë blerëse të familjeve të varfra. Inflacioni në rajonin e EJK6-ës në vitin 2016 ka mbetur në nivele të ulëta megjithë rimëkëmbjen e rritjes ekonomike. Pasi arriti në 1 përqind në vitin 2015, inflacioni rajonal pritet të arrijë në 1.5 përqind në vitin 2016, por duke variuar nga 1.5 përqind në BeH në 2 përqind në Serbi. Çmimet e konsumit pritet që të bien në Mal të Zi, të mbeten të pandryshuara në Kosovë dhe IRJ të Maqedonisë, si dhe të rriten ngadalë në Shqipëri. Shumica e vendeve janë prekur nga çmimet e ulëta të naftës dhe ushqimeve në tregun ndërkombëtar, nga të cilat përfitojnë më shumë familjet me të ardhura të ulëta. Si rezultat, varfëria (e matur si 5 US\$/ditë me kursin e këmbimit të konvertuar në PPP 2005) pritet të reduktohet në të gjithë rajonin në vitin 2016.

Në të ardhmen e afërt rritja ekonomike ka të ngjarë të vazhdojë të mbështesë zhvillimet pozitive në tregun e punës dhe uljen e varfërisë. Me konsolidimin e pritshmërive në lidhje me rritjen ekonomike gjatë vitit të ardhshëm, pritet që rezultatet e tregut të punës të nxisin gjenerimin e të ardhurave dhe mundësitë për punësim, veçanërisht të segmenteve më vulnerabël të popullsisë, duke rezultuar në pritshmëri për reduktim më të shpejtë të varfërisë.


3. Pozicionet e Jashtme Viojnë të Mbeten të Brishta

Niveli mesatar i deficiteve të llogarive korrente të vendeve të rajonit pati një përkeqësim të vogël gjatë vitit 2016, ku ngushtimi i deficitit në Serbi u kompensua nga zgjerimi i tij në vendet e tjera. Disbalanca e jashtme mesatare në vendet e EJL6-ës arriti të përgjysmohej gjatë periudhës 2007-2015 për shkak të nevojës për rregullim si pasojë e krizës globale financiare (Figura 3.1). Deficiti i llogarisë korrente për rajonin llogaritet të jetë 6.6 përqind në vitin 2016, disi më i lartë se niveli prej 6.2 përqind në vitin 2015. Faktorë shtytës për krijimin e kësaj situatë në Shqipëri, Mal të Zi dhe në Kosovë janë niveli i lartë i deficiteve tregtare dhe rënia e remitancave; zgjerimi i deficiteve në BeH dhe IRJ të Maqedonisë shpjegohet me rënien e fluksit të të ardhurave dhe remitancave. Ndërsa në Serbi, në ndryshim nga tendenca në vendet e tjera të rajonit, deficiti i llogarisë

korrente u ngushtua, si rezultat i eksporteve të shëndetshme të produkteve të industrisë përpunuese dhe përmirësimit të bilancit të tregtisë në shërbime.


Deficitet tregtare u zgjeruan në vendet eksportuese të lëndëve të para - por u ngushtuan sërish në vendet eksportuese të produkteve të industrisë përpunuese. Eksportet e mallrave si pjesë e PBB-së pësuan rënie në Shqipëri, Kosovë dhe Malin e Zi, kryesisht për shkak të çmimeve të ulëta në tregun ndërkombëtar të lëndëve të para. Në kontrast, eksportet e produkteve të industrisë përpunuese në Serbi dhe IRJ të Maqedonisë u zgjeruan, si rrjedhojë e rritjes ekonomike pozitive në BE. Ndërkohë, u zgjeruan importet e lidhura me projektet e investimeve dhe rigjallërimin e konsumit.

Figura 3.1. Deficitet e llogarive korrente patën rritje të vogël në 2016, përveçse në Serbi




Burimi: Bankat Qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave.

Figura 3.2. Deficitet tregtare përkeqësuan bilancet e llogarive korrente



Burimi: Bankat Qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave.


Figura 3.3. IHD-të dhe Investimet e Portofolit u reduktuan...



Burimi: Të dhëna nga bankat qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave, parashikime të stafit të Bankës Botërore.

Investimet e Huaja Direkte vijnë të jenë burimi kryesor i financimit të jashtëm për shumicën e vendeve. Flukset e IHD-ve pritet të mbulojnë 20 deri 100 përqind të deficiteve të llogarive korrente të rajonit, pavarësisht rënies si përqindje e PBB-së që pësuan këtë vit në të gjitha vendet e EJL6-ës, me përjashtim të IRJ të Maqedonisë. Shkaqet që çuan në rënie e IHD-ve variojnë nga rënia e investimeve në industrinë nxjerrëse si rezultat i çmimeve të ulëta në tregun ndërkombëtar (Shqipëri), pagesat e dividendëve (Malin e Zi), si dhe vonesave në një projekt të madh investimi (Kosovë). Flukset e investimeve të portofolit kanë pësuar tashmë rënie për disa periudha radhazi, duke reflektuar kështu zhvillimet në tregjet ndërkombëtare edhe pasigurinë politike në disa vende. Raporti i borxhit të jashtëm ndaj PBB-së, nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm, edhe pse shtetet vazhdojnë të përfitojnë nga kushtet ende të favorshme të huamarrjes. Rezervat valutore që mbulojnë 4.5 deri në 7.3 muaj

Figura 3.4...në shumicën e vendeve të EJL6-ës



Burimi: Të dhëna nga bankat qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave, parashikime të stafit të Bankës Botërore.

importe ofrojnë mbështetjen e duhur në rast të përsëritjeve të paqëndrueshmërive në mjedisin e jashtëm.

Tabela 3.1. Shtërëngim i pozicionit të jashtëm të EJL6-ës

Në përqindje ndaj PBB-së	2015 ^f	2016 ^f	2017 ^f	2018 ^f
Eksporti i mallrave	25.3	25.7	26.7	26.9
Bilanci Tregtar	-15.6	-15.2	-15.1	-15.1
Bilanci i llogarisë korrente	-6.2	-6.6	-6.6	-6.4
Investimet e Huaja Direkte	6.0	4.7	4.8	4.8
Borxhi i jashtëm	80.4	80.3	79.4	80.4

Burimi: Të dhëna nga bankat qendrore dhe zyrat kombëtare të statistikave, parashikime të stafit të Bankës Botërore.

Disbalancat e jashtme pritet të ngushtohen gradualisht në të ardhmen e afërt, me rimëkëmbjen e eksporteve. Deficitet e llogarisë korrente pritet të bien në 2017 dhe 2018 në të gjitha vendet, me përjashtim të Kosovës dhe Malit të Zi, kryesisht për shkak të bilancit tregtar në rënie. Eksportet e shërbimeve pritet të rriten në të gjithë rajonin. Eksportet e

mallrave pritet të zgjerohen në Serbi dhe IRJ të Maqedonisë, por të mbeten të ulëta në vendet eksportuese të lëndeve të para. Presionet e importeve pritet të ulen me përfundimin e projekteve të investimeve. Megjithëse paqëndrueshmëria financiare mund të shkaktojë probleme për mbulimin e CAD, IHD-të dhe amortizuesit e jashtëm (të tilla si rezervat e mjaftueshme valutore) ndihmojnë në lehtësimin e presioneve të financimit në shumicën e vendeve të rajonit.


4. Konsolidimi Fiskal po Jep Fryte

Konsolidimi fiskal është në rrugën e duhur për të reduktuar deficitin mesatar fiskal të rajonit në 3.3 për qind të PBB-së në vitin 2016, nga 3.6 për qind në vitin 2015. Përdorimi i gjerë i politikave kundërciklike pas krizës globale nxorri jashtë loje amortizatorët fiskalë dhe çoi në rritje të madhe të borxhit publik në shumicën e vendeve të rajonit. Ndërkohë që rënia e kohëve të fundit është një zhvillim i mirëpritur, pas kësaj rënie në nivelin mesatar të deficitit dallohen dy zhvillime të ndryshme. Shqipëria, BeH, dhe Serbia po vijnë të ndjekin konsolidimin fiskal në vitin 2016, dhe pritet të reduktojnë ndjeshëm deficitet e tyre fiskale (ose t'a mbajnë atë në nivel të ulët në rastin e BeH). Në të kundërt, pozicionet fiskale të Kosovës, IRJ të Maqedonisë, dhe Malit të Zi janë përkeqësuar për shkak të rritjes së shpenzimeve korrente dhe

flukseve të mëdha hyrëse të kapitalit për projektet.


Ndërsa të ardhurat u rritën në të gjitha vendet e EJL6-ës, modelet e ndryshme të shpenzimeve kanë rezultuar në rezultate divergjente fiskale. Reformat e politikave fiskale dhe përpjekjet për përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave në vitin 2015 kanë çuar në rritjen e raportit të të ardhurave ndaj PBB-së në vitin 2016 në Shqipëri, Kosovë dhe IRJ të Maqedonisë dhe kanë ndihmuar në kontrollin e efektit të të ardhurave më të ngadalda njëherëshe (one-off) në BeH. Forcimi i aktivitetit ekonomik ka kontribuar në rritjen e përfitimeve në Serbi dhe Mal të Zi. Reformat shtrënguese të madhësisë së sektorit publik, pagave dhe transfertave publike kanë filluar të japin fryte në Serbi, ku reduktimet në shpenzimet

Figura 4.1. Konsolidimi fiskal reduktoi deficitet në Shqipëri dhe Serbi...



Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe Ministrinë e Financave, parashikime të stafit të Bankës Botërore.

Figura 4.2. ...por presioni i shpenzimeve nuk shoqërohet me rritje të performancës në të ardhura në shumicën e vendeve




Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave dhe Ministrinë e Financave, parashikime të stafit të Bankës Botërore.

